



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 26

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

(TM4 2025 dhe pritjet për TM1 2026)

Numër 26

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Stabilitetit Financiar,
Hulumtimeve dhe Analizave Ekonomike

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Hyrje	5
Përmbledhje.....	6
1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve.....	7
1.1 Standardet kreditore	7
1.2 Kushtet dhe rregullat.....	8
1.3 Kërkesa për kredi.....	9
1.4 Cilësia kreditore.....	10
2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare	10
2.1 Standardet kreditore	10
2.2 Kushtet dhe rregullat.....	11
2.3 Kërkesa për kredi.....	11
2.4 Cilësia kreditore.....	12
3.0 Financimi.....	12
3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuara	13
4.0. Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit	14

Shkurtesat

AKBK – Anketa e Kreditimit Bankar të Kosovës

FKGK – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

NVM- Ndërmarrjet e vogla të mesme

Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

Hyrje¹

Me qëllim parësor thellimin e kuptimit të dinamikave të kreditimit në Kosovë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) realizon anketë periodike me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Si qëllim dytësor, anketa vlerëson pritjet e sektorit bankar lidhur me zhvillimet në nivelin e çmimeve të konsumit (inflacionit) në vend.

Raporti tremujor, që analizon rezultatet e këtij anketimi, ofron pasqyrë të gjerë dhe sistematike mbi perceptimin e rrezikut dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe mbi sjelljen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve ndaj ndryshimeve në kushtet e kreditimit. Përveç pyetjeve standarde, anketa përfshinë edhe pyetje shtesë, të cilat sigurojnë informacion kualitativ për shpjegimin e dinamikave aktuale në sektorin bankar, si dhe për zbërthimin e zhvillimeve të ofertës dhe kërkesës kreditore për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik.

Ky edicion i raportit pasqyron sjelljen kreditore për tremujorin e katërt të vitit 2025, si dhe pritjet e bankave për dinamikat e kreditimit dhe inflacionin në tremujorin e parë të vitit 2026.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

Përmbledhje

Dinamikat e kreditimit bankar në tremujorin e katërt të vitit u nxitën nga oferta dhe kërkesa kreditore, me këtë të fundit me ndikim më të lartë në rrjedhën e kredive të reja për TM4 2025. Oferta kreditore vazhdoi shtrëngimin deri në një masë për ekonomitë familjare kurse për ndërmarrjet mbeti kryesisht e pandryshuar. Në anën tjetër, kërkesa kreditore në përgjithësi shënoi rritje si për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Sa i përket segmenteve të ndryshme, tek ndërmarrjet kishte kërkesë të rritur për NVM-të kurse mbeti e pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Për ekonomitë familjare, kishte rritje për të dy kategoritë - për kreditë për blerje të shtëpive dhe në veçanti për kreditë personale/konsumuese. Për tremujorin vijues (TM1 2026), bankat presin që standardet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara si për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, kurse kërkesa për kredi pritët të jetë më e lartë.

*Për segmentin e ndërmarrjeve, **standardet kreditore** në TM4 2025 mbetën kryesisht të pandryshuara, duke ndërprerë trendin shtrëngues në dy tremujorët paraprak, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët përcaktues ishin konkurrenca bankare dhe jobankare, qasja në burimet financuese dhe kufizimet në pozicionin e kapitalit. **Në kuadër të kushteve dhe rregullave të ofruara**, bankat deklaruan shtrëngim deri në një masë në normën e ofruar të interesit si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha. Ndërsa, kushtet dhe rregullat tjera të kreditimit - maturiteti i kredive, kërkesat për kolateral dhe tarifat tjera - mbetën kryesisht të pandryshuara. **Niveli i aprovimit** të kredive ka shënuar rritje kundrejt rënies së shënuar në tremujorin paraprak. **Kërkesa për kredi** shënoi rritje deri në një masë, kryesisht si rezultat i kërkesës për financim të inventarit-kapitalit punues dhe investimeve fikse nga NVM-të, kurse për ndërmarrjet e mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. **Cilësia e kredive** shënoi rënie të lehtë këtë tremujor, kurse për tremujorin vijues pritët të mbetet kryesisht e pandryshuar. Në TM1 2026, bankat presin që standardet kreditore të mbeten kryesisht të pandryshuara, kurse kërkesa kreditore pritët të rritet, në veçanti për NVM-të. Kushtet dhe rregullat e aplikuar kryesisht pritët të mbesin të ngjashme me tremujorin aktual, me përjashtim të lehtësimit të kërkesave për kolateral për segmentin e NVM-ve.*

*Për segmentin e ekonomive familjare, **standardet kreditore** u shtrënguan deri në një masë për tremujorin e tretë me radhë, me një shtrëngim më të theksuar për kreditë konsumuese dhe afatshkurta. Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë shtrëngim ishin zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore dhe, në një masë më të ulët, perceptimet lidhur me zhvillimet në tregun vendor. Në kuadër të **kushteve dhe rregullave të ofruara**, bankat raportuan shtrëngim deri në një masë në normat e interesit në përgjithësi, ndërsa kushtet dhe rregullat e tjera mbeten kryesisht të pandryshuara nga tremujori paraprak. Përkundër shtrëngimit të standardeve, niveli i aprovimit të kredive shënoi rritje nga tremujori paraprak, me rritje më të theksuar për kreditë konsumuese dhe afatshkurta, duke reflektuar kryesisht rritjen e kërkesës. **Kërkesa për kredi** shënoi rritje deri në një masë në përgjithësi dhe për kreditë konsumuese në veçanti, për dallim nga tremujori paraprak kur u shënuar rënie për këtë kategori. Kërkesa e rritur gjatë këtij tremujori u ndikua kryesisht nga rritja e besueshmërisë së konsumatorit dhe nevojës për financim të shpenzimeve të tjera për konsum. **Cilësia e kredive** shënoi rënie të lehtë, ndërsa për tremujorin në vijim pritët të mbetet kryesisht e qëndrueshme, me tendencë të lehtë rënësë. Për TM1 2026, standardet kreditore pritët të mbesin të pandryshuara në përgjithësi, ndërsa kërkesa për kredi pritët të shënoj rritje, me theks për kreditë personale/konsumuese (Tabela 1).*

Qasja në financim e bankave ka shënuar rritje për tremujorin e dytë me radhë, mbështetur kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe ato të korporatave jo-financiare. Po ashtu, rritje të dukshme ka shënuar edhe financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare, ndërsa në masë më të ulët është rritur financimi brenda grupit. Në tremujorin në vijim, qasja në financim pritët të mbetet e pandryshuar, me tendencë të lehtë rënësë.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore.

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM4 2025	TM1 2026 (pritjet)	TM4 2025	TM1 2026 (pritjet)
Ndërmarrjet	➔	➔	➔	⬆
NVM	➔	➔	➔	⬆
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	➔	➔
Ekonomitë familjare	➔	➔	➔	➔
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	➔	➔
Kredi konsumuese	➔	➔	➔	⬆

⬆ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
 ➔ Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
 ➔ Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
 ➔ Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
 ⬇ Shtrëngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)


Burimi: BQK.

1.0 Kreditë ndaj ndërmarrjeve

1.1 Standardet kreditore

Rezultatet e mesatarizuara² të Anketës së Bankave për TM4 2025 tregojnë se standardet kreditore për segmentin e ndërmarrjeve - për NVM-të, e në veçanti për ndërmarrjet e mëdha - kanë ndërprerë trendin shtrëngues të dy tremujorëve paraprak, pasi që për këtë tremujorë është deklaruar se ato do të mbesin kryesisht të pandryshuara (Grafiku 1). Si për NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha standardet kreditore të aplikuara nga bankat do të ndjekin trendin e përgjithshëm, pra do të mbesin kryesisht të pandryshuara pas dy tremujorëve me radhë ku u raportua shtrëngim, e veçanërisht për këto të fundit.

Grafiku 1. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Shumica e faktorëve me ndikim në standardet kreditore mbetën kryesisht të pandryshuar, siç janë konkurrenca, qasja me e kufizuar në gjithsej burimet financuese, si dhe kufizimet në kapacitetin e bankave. Faktorët me ndikim shtrëngues ishin perceptimi mbi perspektivën e tregut vendor dhe

² Reflektojnë mesataren e peshuar në kreditim të secilës banke.

toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, por efekti i tyre u neutralizua nga faktorët lehtësues si pozicioni më i favorshëm me likuiditet dhe mbështetja e vazhdueshme nga FKGK (Grafiku 2).

Grafik 2. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Për TM1 2026, bankat presin që standardet kreditore për sektorin e ndërmarrjeve të mbesin kryesisht të pandryshuara. Efekt pozitiv pritet të ketë mbështetja nga FKGK. Faktorët të cilët janë cilësuar se do të kenë efekte negative në standardet kreditore, por që pritet të neutralizohen për shkak të ndikimit të tyre të ulët, janë toleranca më e ulët e bankave për të ndërmarr rrezik, cilësia e kredive dhe pozita e likuiditetit (Grafik 2).

1.2 Kushtet dhe rregullat

Në TM4 2025, kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet shfaqën shtyrje vetëm në komponentën e normës së interesit (Grafiku 3). Konkretisht, bankat raportuan se pati një rritje të normës së interesit si për NVM-të, ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, duke vazhduar trendin shtyrës për të katërtin tremujor radhazi. Ndryshe nga tremujori paraprak, kur u shënua shtyrje edhe në madhësinë e kredisë, në TM4 kjo kategori mbeti kryesisht e pandryshuar. Po ashtu, elementet e tjera të kushteve të kreditimit – si maturiteti i kredive, kërkesat për kolateral dhe tarifatat e tjera – mbetën në përgjithësi të pandryshuara. +.

Grafik 3. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët të cilët ndikuan në kushtet dhe rregullat e kreditimit për segmentin e ndërmarrjeve, veçanërisht në drejtim të shtyrjes së normave të interesit, lidhen kryesisht me perceptimin mbi perspektivën ekonomike në tregun vendor, cilësinë e portfolit kreditor (rritjen e lehtë të kredive joperformuese) si dhe me uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut. Nga ana tjetër, faktorët me ndikim pozitiv përfshijnë mbështetjen e vazhdueshme nga FKGK, pozicionin e qëndrueshëm të likuiditetit dhe nivelin e konkurrencës në treg, të cilët kanë kontribuar që kushtet dhe rregullat e tjera të kreditimit të mos shtyrë më tej. Në tremujorin vijues, kushtet dhe rregullat e aplikuara


nga bankat pritet të mbesin kryesisht të pandryshuara me tremujorin aktual, me përjashtim të lehtësimit në kërkesën për kolateral për segmentin e NVM-ve.

Në TM4 2025, niveli i aprovimit të kredive për ndërmarrjet shënoi rritje. Konkretisht kishte nivel më të lartë të aprovimeve për kreditë për NVM-të dhe kreditë me maturitet afatshkurtër. Për tremujorin vijues, niveli i aprovimit pritet të rritet konsiderueshëm për të dy segmentet, e në veçanti për NVM-të, si për kreditë me maturitet afatshkurtër ashtu edhe ato afatgjata.

1.3 Kërkesa për kredi

Sipas rezultateve të anketës, kërkesa për kredi në TM4 2025 shënoi rritje, kryesisht si rezultat i kërkesës më të lartë prej NVM-ve, ndërsa kërkesa prej ndërmarrjeve mbeti kryesisht e pandryshuar. Për NVM-të, bankat deklaruan rritje të kërkesës si për kreditë me maturitet afatshkurtër ashtu edhe për ato afatgjata (Grafiku 4).

Grafiku 4. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan pozitivisht kërkesën e përgjithshme për kredi nga ndërmarrjet këtë tremujor ishin nevoja për investime në inventar dhe kapital punes, si dhe për financim të investimeve fikse (Grafik 5).

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet mbeti kryesisht e pandryshuar në këtë tremujor, por pritet të përmirësohet lehtësisht në TM1 2026.

Grafik 5. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Në TM1 2026, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, me theks të veçantë të NVM-të. Rritje e kërkesës pritet në të gjitha segmentet e maturitetit. Faktorët me ndikim në këtë dinamikë do

të jenë kryesisht nevojat për financimin e inventarit dhe kapitalit punues dhe në masë më të ulët kërkesa për financimin e investimeve fikse.

1.4 Cilësia kreditore


Bankat në përgjithësi raportuan për rritje të ulët të kredive joperformuese për segmentin e ndërmarrjeve. *Për TM1 2026, pritjet që nivel i KJP-ve të mbetet kryesisht i pandryshuar.*

2.0 Kreditë ndaj ekonomive familjare

2.1 Standardet kreditore

Bazuar në rezultatet e Anketës së Kreditimit për TM4 2025, standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare në përgjithësi, u shtrënguan deri në një masë, duke vijuar trendin shtrëngues për të tretin tremujor radhazi (Grafiku 6). Shtrëngimi ishte më i theksuar për kreditë konsumuese dhe ato afatshkurtra, krahasuar me kreditë për blerje të shtëpive dhe ato afatgjata.


Grafiku 6. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan në shtrëngim të standardeve kreditore ishin zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore, përkatësisht rritja e lehtë e kredive joperformuese, si dhe perspektiva e tregut vendor (Grafiku 7). Në kahun lehtësues, ndonëse në një masë të kufizuar, ndikoi pozita e favorshme e likuiditetit.

Grafik 7. Faktorët ndikues në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Për TM1 2026, standardet kreditore për ekonomitë familjare pritjet të mbesin të pandryshuara në përgjithësi, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për ato për blerje të shtëpive. Këto pritje mbështeten nga konkurrenca ndërbankare dhe nga perspektiva e tregut vendor, ndërsa pozita e likuiditetit pritjet të ndikojë në një masë më të kufizuar.

2.2 Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare u shtrënguan deri në një masë, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu dhe për ato konsumuese (Grafiku 8). Më konkretisht, në kuadër të kushteve dhe rregullave, u deklaruan për shtrëngim në normën e interesit, ndërsa kushtet dhe rregullat e tjera mbeten kryesisht të ndryshuara. Faktorët që ndikuan në këtë shtrëngim ishin, qasja në gjithsej financim, perspektiva e tregut vendor dhe cilësia e portfolios kreditorë.

Grafik 8. Kushtet dhe rregullat e aplikuara në standardet kreditore për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Për TM1 2026, ashtu si në tremujorin paraprak, bankat presin lëvizje në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare, në të dy kahet. Më konkretisht, pritjet lehtësim në normën e interesit në kreditë për blerje të shtëpive, ndërsa për ato konsumuese normat e interesit pritjet të mbesin kryesisht të pandryshuara, por të shoqëruara me shtrëngim deri në një masë në maturitetet.

Niveli i aprovimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare shënoi rritje krahasuar me tremujorin paraprak, me rritje më të theksuar për kreditë konsumuese dhe ato afatshkurtra, duke reflektuar kryesisht rritjen e kërkesës, ndërkohë që standardet kreditore për këtë kategori mbetën të shtrënguara. *Për tremujorin e parë të vitit 2026, niveli i aprovimit pritjet të shënoj rritje të lehtë për ekonomitë familjare në përgjithësi.*

2.3 Kërkesa për kredi

Bazuar në rezultatet e anketës për TM4 2025, ndryshe nga tremujori paraprak, kërkesa e përgjithshme për kredi nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje deri në një masë (Grafiku 9). Rritje më e theksuar gjatë këtij tremujori u shënuar për kreditë konsumuese, krahasuar me rritjen e kërkesës për kreditë për blerje të shtëpive.


Grafik 9. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Faktorët kryesorë që ndikuan kërkesën e përgjithshme për kredi nga ekonomitë familjare ishin rritja e besueshmërisë së konsumatorëve dhe nevoja për financim të shpenzimeve për konsum (Grafiku 10). Për TM1 2026, kërkesa pritet të shënoj rritje më të lartë, me theks për kreditë konsumuese.

Grafik 10. Faktorët që ndikuan kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare, ngjashëm me tremujorin paraprak, ka mbetur e pandryshuar, *dinamikë e cila pritet të vazhdoj edhe në tremujorin e parë të vitit 2026.*


2.4 Cilësia kreditore

Bankat raportuan një rritje të lehtë të nivelit të kredive joperformuese nga tremujori i kaluar. Për TM1 2026, ky tregues pritet të shënoj rritje, por me ritëm më të ulët se në tremujorin aktual.

3.0 Financimi

Në TM4 2025, qasja në financim e bankave ka shënuar rritjen më të lartë gjatë këtij viti. Ky zhvillim ishte rezultat i rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare, të cilat shënuan rritje të konsiderueshme sipas deklaratimit nga shumica e bankave. Rritje të dukshme gjatë këtij tremujori ka shënuar edhe financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare, ndërsa financimi brenda grupit shënoi rritje më të ulët nga tremujori i kaluar. Sa i përket maturitetit, financimi afatshkurtër u rrit më shumë sesa ai afatgjatë (Grafiku 11).

Grafik 11. Ndryshimi në financimin e e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Në tremujorin e parë të vitit 2026, qasja në gjithsej financim pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar, me tendencë të lehtë rënëse. Rritje deri në një masë pritet të shënojnë depozitat e ekonomive familjare, financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe tregu i parasë ndërbankare, ndërsa, financimi nga korporatat jofinanciare pritet të mbetet kryesisht i pandryshuar.

3.1 Përmbledhje e pyetjeve të fokusuar

Pyetësi i anketës për TM4 2025 është plotësuar me dy pyetje shtesë, të cilat kanë për qëllim zgjerimin e përmbajtjes së anketës përtej pyetjeve standarde që lidhen me ofertën dhe kërkesën kreditore dhe faktorët ndikues mbi to. Bankat janë pyetur lidhur me rreziqet kryesore ndaj të cilave janë të ekspozuara dhe si do të ndikojnë ato në aktivitetin e tyre, si dhe qasjen që do të ndjekin për të siguruar financim për ruajtje të pozicionit të qëndrueshëm me likuidet dhe njëkohësisht mbështetjet të aktivitetit kreditues.

Në përgjigjet e dhëna rreth pyetjes së parë, në përgjithësi, bankat vlerësojnë se rreziqet kryesore për vitin 2026 mbeten të menaxhueshme, me shkallë ndikimi kryesisht të ulët. Konkretisht, si rrezik kryesorë, por i menaxhueshëm, është cilësuar rreziku i rritjes së kredive joperformuese (KJP-ve) i ndikuar nga faktorë makroekonomikë si inflacioni, ngadalësimi ekonomik dhe presionet në qarkullim (ang. cash-flow), veçanërisht për bizneset. Rreziku i likuiditetit është konsideruar përgjithësisht i ulët për shkak të bazës së qëndrueshme të depozitave. Bankat, gjithashtu, kanë identifikuar rrezikun makroekonomik dhe politik si rreziqe potenciale, kryesisht rreziqet nga vonesat në formimin e institucioneve dhe rrezikun e mbylljes ose mos miratimit të buxhetit. Megjithatë, ato kanë ndërmarrë masa parandaluese për të zbutur efektet e mundshme, përmes rritjes së nivelit të provizionimit.

Në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetjen e dytë, në përgjithësi, bankat kanë deklaruar për qasje të kujdesshme dhe prudente për rritje të shëndoshë duke ruajtur indikatorët kyç të likuiditetit. Konkretisht, bankat kanë deklaruar për ruajtje të nivelit të lartë të treguesve të likuiditetit përmes menaxhimit konservator dhe monitorimit të vazhdueshëm; diversifikimit të burimeve të financimit, kryesisht përmes bashkëpunimit me institucione financiare ndërkombëtare, si masë plotësuese, si dhe rritje të kreditimit pa rrezikuar qëndrueshmërinë e likuiditetit.

Sa i përket përgjigjeve të disagreguara të bankave për ndërmarrjet sipas sektorëve ekonomik, standardet kreditore si dhe kushtet dhe rregullat e aplikuara mbeten kryesisht të pandryshuara, me një tendencë të lehtë shtrënguese në kushtet e ofruara për sektorin e ndërtimit. Ngjashëm me tremujorin e kaluar, kërkesa kreditore në TM4 2025 shënoi rritje pothuajse nga të gjithë sektorët ekonomik, me theks të veçantë për sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore. Në tremujorin vijues, standardet kreditore pritet të lehtësohen për sektorin e shërbimeve, kurse për sektorët tjerë kryesisht do të mbeten të pandryshuara. Ngjashëm, edhe kushtet dhe rregullat e aplikuara do të mbesin kryesisht të pandryshuara, me përjashtim për sektorin e ndërtimit që do të ketë shtrëngim deri në një masë.

Kërkesa kreditore pritet të jetë dukshëm më e lartë, veçanërisht në sektorin e pasurisë së paluajtshme banesore, pasuar nga prodhimi dhe sektori i shërbimeve. Kërkesë në rritje pritet edhe për sektorin e ndërtimit, por më e ulët krahasuar me sektorët e tjerë ku pritet rritje.

4.0. Përmbledhja e rezultateve për pritjet e inflacionit

Të dhënat nga anketa e janarit 2026 tregojnë se bankat komerciale presin që inflacioni në tremujorin e parë të vitit 2026 të shënojë një ngadalësim të lehtë krahasuar me tremujorin paraprak. Sipas vlerësimeve të tyre, norma e inflacionit pritet të ngadalësohet në 4.6 përqind në tremujorin e parë të vitit 2026 nga 5.2 përqind në tremujorin paraprak, ndërsa mesatarja vjetore për vitin 2026 pritet të jetë rreth 4.2 përqind (Tabela 2).

Duke pasur parasysh se inflacioni mesatar në vitin 2025 ishte 3.9 përqind, niveli i pritur për vitin 2026 nënkupton një rritje krahasuar me vitin paraprak, pavarësisht pritjes për zbutje graduale brenda vetë vitit 2026.


Tabela 2. Pritjet e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM4 2025	TM1 2026	2026
1	5.0%	4.0%	3.5%
2	5.3%	4.5%	3.2%
3	5.2%	4.9%	4.7%
4	5.3%	4.5%	3.5%
5	5.3%	5.2%	4.3%
6	5.2%	4.9%	4.6%
7	5.3%	5.3%	5.0%
8	5.3%	5.5%	5.5%
9	5.3%	2.7%	2.7%
10	5.3%	5.0%	5.0%
Mesatarja	5.2%	4.6%	4.2%

Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

Figura 12 paraqet vlerësimin e bankave mbi probabilitetin e realizimit të niveleve të ndryshme të inflacionit. Rezultatet tregojnë për zhvendosje të pritjeve drejt niveleve më të larta të inflacionit krahasuar me anketën e tremujorit të tretë të vitit 2025. Në atë periudhë, pritjet për tremujorin pasues ishin kryesisht të përqendruara në intervalin 3.9–4.9 përqind, ndërsa aktualisht shpërndarja është zhvendosur drejt intervaleve 4.0–5.9 përqind. Kjo zhvendosje sugjeron rritje të perceptimit për rreziqe në kahun rritës të inflacionit, edhe pse norma e pritur për tremujorin e parë të vitit 2026 tregon një ngadalësim krahasuar me tremujorin paraprak. Zhvillime të tilla janë në përputhje me ecurinë e IHÇK, i cili u përsheptua nga 4.5 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2025 në 5.2 përqind në tremujorin e katërt.

Grafik 12. Probabiliteti i inflacionit (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

Pritjet e bankave për inflacionin në periudhën e ardhshme pasqyrojnë ndikimin e disa faktorëve kryesorë që kanë nxitur rritjen e çmimeve deri tani dhe pritet të vazhdojnë të ushtrojnë presionet inflacioniste. Rritja e çmimeve të ushqimit, që përbën një pjesë të konsiderueshme të shportës së konsumit, mbetet një nga nxitësit kryesorë të inflacionit sipas bankave dhe pritet të vazhdojë të ndikojë edhe në periudhën në vijim, kryesisht për shkak të varësisë së lartë të vendit nga importet dhe zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare. Po ashtu, përsheptimin e inflacionit bankat e lidhin edhe me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike, veçanërisht gjatë sezonit dimëror, kur kërkesa është më

e lartë. Ndërsa, në shkallë më të ulët, çmimet e shërbimeve të hotelerisë kanë kontribuar gjithashtu në rritjen e inflacionit.

Megjithëse inflacioni pritet të mbetet i lartë në pjesën e parë të vitit 2026, krahasuar me mesataren e vitit 2025, pritjet janë për një zbutje të tij gjatë gjysmës së dytë të vitit. Sidoqoftë, perspektiva vazhdon të minohet nga ndikimet e jashtme, përfshirë pasiguritë lidhur me çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare, tensionet gjeopolitike dhe varësinë nga importet, të cilat sipas bankave mbeten burime të rëndësishme pasigurie për ecurinë e inflacionit.

Në përgjithësi, bankat parashikojnë një ngadalësim të lehtë të inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2026, në 4.6 përqind, përkundër tendencës rritëse të inflacionit në fund të vitit 2025. Po ashtu, pritjet për inflacion vjetor prej 4.2 përqind në vitin 2026 sugjerojnë që inflacioni do të mbetet mbi nivelin e vitit 2025, por me një trajektore zbutëse përgjatë vitit 2026.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë personale/konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuar gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuar për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen. Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar. Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.

Pritjet për inflacionin

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore. Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e madhe për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, shërbejnë gjithashtu si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse publiku beson se banka qendrore do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të arritur objektivin e inflacionit, atëherë pritjet e agjentëve ekonomik për shkallën e inflacionit do të jenë më të afërta me objektivin e përcaktuar.

Pritjet e inflacionit janë gjithashtu të rëndësishme për bankat që nuk posedojnë politikë monetare, pasi ato shërbejnë si input i rëndësishëm për përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe për procesin e modelimit dhe parashikimit ekonomik. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, e cila më pas ndikon në ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual, i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Një prej metodave më të përdorura është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore dhe shoqërohen me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore: fillimisht për tremujorin aktual, pastaj për tremujorin e ardhshëm dhe për vitin në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org